

23 tetor 2025,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.10.2025, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.07/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave sipas detyrës zyrtare dhe ankesës se paraqitur nga KBF Peja 03 dhe KBF Prishtina ka shqyrtuar incidentin e ndodhur ne mes te lojtareve Besiana Martinaj KBF Prishtina dhe Arbnore Përçuku KBF Peja 03 .
- II. Komisioni i garave pas shqyrtimit të kësaj kërkesë e bazuar në Propozicionet e Garave për kategoritë seniore Edicioni 2025/2026, ka gjetur se **lojtarja Besiana Martinaj KBF Prishtina ka bërë shkeljen e paraparë me nenin 52.14 të PG dhe Arbnore Përçuku KBF Peja 03 ka bërë shkeljen e parapare me nenin 52.12.**
- III. Vendimi hyn në fuqi nga data e publikimit.

ARSYETIM

Gjatë vendimarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.07/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

(a) Nga incizimet zyrtare dhe raportet e delegatit dhe gjyqtarëve të ndeshjes së zhvilluar ndërmjet KBF Peja 03 dhe KBF Prishtina, është konstatuar se në çerekun e katërt, minuta 06:37, pas referimit të një gabimi personal lojtares Arbnore Përçuku (KBF Peja 03) gjatë aksionit të realizuar nga Besiana Martinaj (KBF Prishtina), ka ndodhur një incident ndërmjet këtyre dy lojtareve. Gjatë shkaktimit të gabimit personal, lojtarja Arbnore Përçuku nga incizimi shihet se e ka goditur disa herë lojtaren Besiana Martinaj. Ky veprim nga gjyqtarët është referuar vetëm si gabim i thjeshtë personal. Pas kësaj, lojtarja Besiana Martinaj ka tentuar të sulmojë lojtaren Arbnore Përçuku, mirëpo falë reagimit të shpejtë të lojtareve të dy ekipeve dhe të gjyqtarëve të ndeshjes, nuk ka ardhur deri te ndonjë përleshje fizike. Nga gjyqtarët lojtarja Besiana Martinaj ndëshkohet me Gabim teknik – diskualifikues kurse lojtarja Arbnore Përçuku me gabim teknik.

(b) Andaj, Komisioni i Garave ne përputhje me nenin 54.2 të PG pas vlerësimit të incizimeve dhe raporteve zyrtare gjen se lojtarja Besiana Martinaj ka bërë shkeljen e paraparë me nenin 52.14 të Propozicioneve të garave kurse lojtarja Arbnore Përçuku KBF Peja 03 ka bërë shkeljen e paraparë me nenin 52.12 të Propozicioneve të garave dhe shqipton këtë dënim:

- lojtarja Besiana Martinaj KBF Prishtina¹, ndëshkohet me 1 (një) ndeshje moslojë dhe 300€ (treqind) euro gjobë.


-lojtarja Arbnore Përçuku KBF Peja 03, ndëshkohet me 1 ndeshje moslojë

¹ Dënimi zbatohet në xhiron e pestë, meqë për shkak të gabimit përjashtues është shqiptuar dënim edhe për xhiron e katërt.

Komisioni i Garave:

Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.